- Presidenti i Republikës, Kryeministri, zvkryeministri, ministrat, ose zvministrat, Deputetet, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët e Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë e në atë të Apelit, Avokati i Popullit, Anëtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Anëtarët e Enteve Rregullatore, (Këshilli i Mbikqyrjes i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zv/Guvernatorin; të konkurrencës, telekomunikacionit; energjisë; furnizimit me ujë; të sigurimeve; letrave me vlerë; mediave), Sekretarët e Përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar tjetër, në çdo institucion publik, që është të paktën i barazvlefshëm për nga pozicioni me drejtorët e përgjithshëm, titullarët e institucioneve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për zyrtarët e nivelit të mesëm drejtues sipas nenit 31, dhe për zyrtarët e parashikuar në nenin 32 të kreut të III, seksioni 2 të këtij ligji, ndalimi sipas pikës 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave në fushën e territorit dhe të juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë është një institucion i varësisë.

Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nënkryetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave privatë të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie (neni 21 pika 2 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005).

## Dokumentat Standarde të Tenderit

Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin që në kuptim të këtij ligji janë **bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi, fëmijë në moshë madhorë, prindërit e zyrtarit të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es.**

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në **Kreun III, Seksioni II** të Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

**Data e dorëzimit të deklaratës** \_\_\_\_\_

**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi**

\_\_\_\_\_

**Vula** \_\_\_\_\_

## Shtojca 8

[ Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]

### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

**Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.**

**Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 5.**

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

**Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:**

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

### 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;

b. Deklarate për paraqitje oferte të pavaruar, sipas Shtojcës 2/1;

c. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës

*sipas Shtojcës 5/1;*

*ç.Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6;*

*d.Deklaraten mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;*

*dh. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

### **2.1. Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:**

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një certifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të shoqërisë, sipas standardit ndërkombëtar ISO 9001. Certifikata duhet të jetë në fuqi, e vlefshme në ditën e hapjes së procedurës dhe të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.

*Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 74 të VKM-914 datë 29.12.2014, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marrë përsipër të realizoj sipas aktmarrëveshjes.*

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të deklaratave të xhiros vjetore ose vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron e realizuar në tre vitet e fundit nga data e zhvillimit të procedurës, vlera mesatare e të cilës të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit total (vlera e pritshme e kontratave).
2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të certifikuar të bilanceve të viteve: 2017, 2018 të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore.

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit total (vlera e pritshme e kontratave). Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
  - Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga institucioni shtetëror ose faturat tatimore ku të shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.
  - Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.
2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë se merr përsipër dërgimin e mallit objekt prokurimi në adresën e autoritetit kontraktor.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

## Shtojca 9

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]

### **SPECIFIKIMET TEKNIKE**

➤ Specifikimet teknike të veshjeve sportive do të jenë si më poshtë :

**1. Komplet përfaqësimi (Xhaketë sporti + tuta të gjata).**

Përbërja e xhaketës 100 % poliestër viskoze e hollë pesha 120 g/m<sup>2</sup> dhe me astar pambuku nga brënda ku përbërja e astarit është 100 pambuk, 110 g/m<sup>2</sup>. Xhaketa me zinxhir dhe menga me manshet me dy xhepa të pjerrët që mund të mbyllen me zinxhirë. Tutat me llastike te pjesa e belit dhe dy xhepa që mund të mbyllen me zinxhir me manshetë llastiku në fund të këmbëzave. Përbërja e tutave 100 % poliestër viskoze e hollë me peshë 120 g/m<sup>2</sup> dhe me



astar nga brënda ku përbërja e astarit është 100 pambuk, 110 g/m<sup>2</sup>.

Tek xhaketa në pjesën e djathtë, para do të vendoset logoja e shkollës me stampë, me përmasa 5 cm x 8 cm.

Ngjyra e xhaketes do të jetë jeshile me një shirit të bardhë, me gjerësi 1.5 cm në pjesën e supit. Tutat do të jenë ngjyrë jeshile.

Sasitë e pritshme: 70 copë Large dhe 70 copë Extra Large.

2. Uniforma perfaqesimi per ndeshjet (Bluzë me mëngë të shkurtra dhe mbadhje futbollit të shkurtra).

Përbërja : 100 % poliestër (uniklima/vetajrosje), pesha 140g/m<sup>2</sup>. Vendorsja e numrave nga 2 – 20 në pjesën mbrapa të bluzës (për ekipin) dhe numrin 1 (për portierin) me stampë në mbi 50 % të sipërfaqes së pasme. Në pjesën para të bluzës në krahun e majtë do të vendoset logoja e shkollës me stampim me përmasa 5 cm x 8 cm. Te mbathja në krahun e majtë të vendoset numri korrespondues i bluzës me përmasa 5 cm x 8 cm.

Ngjyra e bluzës busti para dhe mbrapa do të jenë në ngjyrë jeshile, ndërsa mëngët në ngjyrë të bardhë, ndërsa mbathjet në ngjyrë të bardhë ndërsa në dy pjesët anësore në gjatësinë e mbadhjeve do të jetë me shirita me gjerësi 1.5 cm me ngjyrë jeshile.

Sasitë pritshme : 140 copë Large. (126 copë për ekipet dhe 14 copë për portierët).

#### Logoja e shkollës “Loro Borici”, Tiranë.



#### ➤ Specifikimet teknike për veshjet speciale të baletit do të jenë si më poshtë:

1. Veshje burrash Tirane.



Veshje Burrash Tirane

Përbërja:

Jeleku: përbërja stof me fije leshi, pesha 220 gr/m<sup>2</sup> ngjyre vishnje I endisur me gajtana ngjyre ari dhe te zeza te dredhura 21 dhe 42 fijesh ne vende te caktuara do te punohet me rokoko qendismat e bejne te ngjeshur pjesen e parme. 90\100 e pjeses se parme eshte e qendisur.

Kemisha: cope pelhure pambuku e punuar ne vegj, ngjyre pane, e punuar me fije pambuku dhe ne cdo shpat te punuar spikat ngjeshja e penit te holle dhe te trashe, e qendisur te menget dhe te jaka.

Brekushet: cope pëlhurë e trashë pambuku vegje ose e cila pritet ne forme te gjere te beli dhe e ngushte te kembet, qendiset te xhepat dhe te kembet, ngjyrë pane.

Brezi: I përbërë nga fije leshi I cili punohet ne vegje Rrip I gjate 3m dhe I gjere 0.2m me ngyra te kuqe dhe te zeze ku ne formen e zburkimeve perdoret edhe e bardh

Qeleshe e punuar me lesh ne forne konike, e prere ne maje

Sasia e pritshme 8 copë.

2. Veshje vajzash Tirane të Shqipërisë së mesme.



Veshje Grash Tirane.

Përbërja :

Jeleku : përbërja 100 % pambuk perbehet nga kadife 180 gr/m<sup>2</sup> ngjyre vishnje e perpunuar me frazeline , qendiset me fije peri ngjyre ari ne trashesine nr 75 I cili para se te qendiset perpunohet duke e dredhur 18 fijesh dhe 21 fijesh dhe 42 fijesh . qendisja e jelekut ne menyre artizanale me fije ari n dizajn e gjethit te terfilit . 90\100e copes eshte e qendisur

Bluza :Copë pelhure pambuk me rripa mëndafshi e punuar ne vegje e qendisur te menga me fije ari e punuar me te came ku ne fund te menges ganityra punohet me tantelle grepi ose gjilpere

90\100e copes eshte e qendisur te menga

Perparese : Copë 100 % saten e cila mund te qendiset me fije ngjyre ari ose argjendi me format e gjethit dhe lules se kumbulles dhe mund te vedose e qendisore dhe nje flutur ose shqiponje e vogel me permasa 80 cm gjeresi dhe 150 cm gjatesin. 50\100 e copes eshte e qendisur

Dimiqt : Copë 100 % saten e cila pritret dhe qepet sipas originalit te vjeter gjere te beli dhe 2.5 shpati I gjate

Kapelja : përbërja 100 % pambuk, cop kadife e qendisur me fije ari ne rripin e te ciles vendosen edhe disa varse ne formen e lekeve ngjyre ari.

Sasia e pritshme 8 copë.

### 3. Veshje tradicionale Librazhdi (vajzash).



Veshje Librazhdi

Përbërja :

Zhguni : copë shajak 250 gr/m<sup>2</sup> leshi e bardhe e prere ne fome te nje pelerine me gjatesi 80 cm e qendisur me fije pambuku me ngjyra te ndryshme ne qendisje mund te perdoret edhe gajtani ngjyre ari

Bluza : Cop pelhure pambuku e qendisur me fije pambuku te faqja e parme dhe te menget

Fustani : pelhure pambuku e bardhe e qepur me shum rruadha dhe e punuar me makine ne fund te saj

Perparsja : Copë pelhure pambuku e endur ne vegj me fije pambuku me ngjyre te me shirita me ngjyre te verdh blu dhe te bardhe

Corapet : fije leshi te punuara me shtiza me ngjyra te ndryshme ku mbizotron vishnja me motive lulesh

Sasia 8 copë.

### 4. Veshje burrash jugu.



Veshje burrash jugu.

Përbërja :

Jelek : Cop stof leshi I zi I punuar per te qene I forte I qendisur te faqet e parme me gajtane 42 fijesh dhe gajtane te trashe te punuara me dore ngjyre ari u shoqeruar edhe me kopsa te punuara me dore ngjyre ari .

Kemisha : copë pelhure pambuku e bardhe me mengorete gjera e qendisur te jaka.

Fustanella : Cope e bardhe pelhure pambuku fund I prere ne forma trekendeshe ku ne fund te tij duhe te formohe 120 pala te njetrajtshme per te perdoret 20 m pelhure gjatesia e fustanelles eshte deri te gjuri.

Kallqat : përbërja lesh I bardha te qendisura me gajtane te zezë.

Brezi : fije leshi e punuar ne vegj, gjeresi 0.30 m, gjatesia 3 m

Qeleshe : shajak leshi I bardhe I punuar ne forme konike ne kallupn me nje antene ne maje te saj.

Sasia e pritshme 8 copë.

## 1. PACKA PROFESIONALE

### a. ROLI “RAIMONDA”



Packa perbehet nga dy elemente 1-busti dhe 2- tutu.

Per realizimin e bustit dhe fundit do te perdorim material tafta.

Stolisia do realizohet me shirita te qendisur me fije akriliku ngjyre floriri, aplikua dhe gure me reflekse.

Per realizimin e tutu-s do te perdorim tyl te ashper I vecante per packa klasike profesionale me veti mosrrudhosje,I cili qepet ne menyre artizanale ku merr formen ideale me vendosjen e pjeses metalike profesionale. Sasia e domosdoshme e tyllit per packen 16 m.

Kjo packe vjen e shoqeruar gjithashtu dhe me aksesoret qe po ashtu jane punime artizanale perkatesisht kurora me rruaza kristali

Materialet teknike te kostumit :

-fije pambuku

-llastik pambuku

-brileta

Sasia 1

#### **b. ROLI “BUKUROSHJA E FJETUR”.**



Packa perbehet nga dy elemente 1-busti dhe 2- tutu.

Per realizimin e bustit dhe fundit do te perdorim material tafta.

Stolisia do realizohet me shirita te qendisur me fije akriliku ngjyre floriri, aplikua dhe gure me reflekse.

Per realizimin e tutu-s do te perdorim tyl te ashper I vecante per packa klasike profesionale me veti mosrrudhosje,I cili qepet ne menyre artizanale ku merr formen ideale me vendosjen e pjeses metalike profesionale. Sasia e domosdoshme e tyllit per packen 16 m.

Kjo packe vjen e shoqeruar gjithashtu dhe me aksesoret qe po ashtu jane punime artizanale perkatesisht kurora me rruaza kristali

Materialet teknike te kostumit :

-fije pambuku

-llastik pambuku

-brileta

Sasia 1

**c. ROLI “MJELMA E BARDHE”**



Packa perbehet nga dy elemente 1-busti dhe 2- tutu.

Per realizimin e bustit dhe fundit do te perdorim material tafta.

Stolisia do realizohet me shirita te qendisur me fije akriliku ngjyre argjendi, aplika,pend dhe gure me reflekse.

Per realizimin e tutu-s do te perdorim tyl te ashper I vecante per packa klasike profesionale me veti mosrrudhosje, I cili qepet ne menyre artizanale ku merr formen ideale me vendosjen e pjeses metalike profesionale. Sasia e domosdoshme e tylit per packen 16 m.

Kjo packe vjen e shoqeruar gjithashtu dhe me aksesoret qe po ashtu jane punime artizanale perkatesisht kurora me pend origjinal

Materialet teknike te kostumit :

- fije pambuku
  - llastik pambuku
  - brileta
- Sasia 1

**d. ROLI “MJELMA E ZEZE”**



Packa perbehet nga dy elemente 1-busti dhe 2- tutu.

## Dokumentat Standarde të Tenderit

Per realizimin e bustit dhe fundit do te perdorim material tafta.

Stolisia do realizohet me shirita te qendisur me fije akriliku ngjyre argjendi, aplika, pend dhe gure me reflekse.

Per realizimin e tutu-s do te perdorim tyl te ashper I vecante per packa klasike profesionale me veti mosrrudhosje, I cili qepet ne menyre artizanale ku merr formen ideale me vendosjen e pjeses metalike profesionale. Sasia e domosdoshme e tylit per packen 16 m.

Kjo packe vjen e shoqeruar gjithashtu dhe me aksesoret qe po ashtu jane punime artizanale perkatesisht kurora me pend origjinal

Materialet teknike te kostumit:

-fije pambuku

-llastik pambuku

-brileta

Sasia 1

### 2. PULLUPACKA PROFESIONALE (S/M/L)



Pullupacka perbehet nga dy elemente 1-busti dhe 2- tutu.

Per realizimin e bustit do te perdorim material velut.

Stolisia do realizohet me shirita te qendisur me fije akriliku ngjyre pana, aplika dhe lule.

Per realizimin e tutu-s do te perdorim tyl I bute I vecante per packa klasike profesionale me veti mosrrudhosje,I cili qepet ne menyre artizanale .Sasia e domosdoshme e tylit per pullupackes 16 m.

Kjo pullupack vjen e shoqeruar gjithashtu dhe me aksesoret qe po ashtu jane punime artizanale perkatesisht kreher me lule dhe gjethe.

Materialet teknike te kostumit:

-fije pambuku

-llastik pambuku

-brileta

Sasia e pritshme 7

### 3. PULLUPACKA GJYSËMPROFESIONALE (S/M/L)



Pullupacka perbehet nga dy elemente 1-badi dhe 2- tutu.

Per realizimin e badit do te perdorim material likra.

Stolisia do realizohet me shirita te qendisur me fije akriliku ngjyre tulle, aplika dhe lule.

Per realizimin e tutu-s do te perdorim tyl I bute I vecante per packa klasike profesionale me veti mosrrudhosje, I cili qepet ne menyre artizanale. Sasia e domosdoshme e tylit per pullupackes 16 m.

Kjo ppullupacke vjen e shoqeruar gjithashtu dhe me aksesoret qe po ashtu jane punime artizanale perkatesisht kreher me lule dhe gjethe.

Materialet teknike te kostumit:

-fije pambuku

-llastik pambuku

-brileta

Sasia 7

#### **4. KEMISHA PER MESHKUJ (S/M/L)**



Kemishat do te realizohen me museline.

Stolisia do realizohet me shirita te punuar me fije akriliku ngjyre floriri dhe komca elegante ngjyre floriri te madhesis mesatare. Tantell statike me bordur.

Materialet teknike te kostumit:

-fije pambuku

-llastik pambuku

-brileta

Sasia 7

#### **5. STRECE PER MESHKUJ**





Strece profesionale te realizuara me material liker elastike

Materialet teknike te kostumit:

- fije pambuku
  - llastik pambuku
  - brileta
- Sasia e pritshme 7

#### 6. “PULLUPACKA TE VOGLA”(10,12,14)



Pullupacka perbehet nga dy elemente 1-badi dhe 2- tutu.

Per realizimin e badit do te perdorim material likra.

Stolisia do realizohet me shirita te qendisur me fije akriliku ngjyre tulle, aplika dhe lule.

Per realizimin e tutu-s do te perdorim tyl I bute I vecante per packa klasike profesionale me veti mosrrudhosje,I cili qepet ne menyre artizanale .Sasia e domosdoshme e tylit per pullupackes 16 m.

Kjo pullupacke vjen e shoqeruar gjithashtu dhe me aksesoret qe po ashtu jane punime artizanale perkatesisht kreher me lule dhe gjethe.

Materialet teknike te kostumit :

- fije pambuku
  - llastik pambuku
  - brileta
- Sasia 7

#### 7. TUTU (S/M/L)



Packa perbehet nga dy elemente 1-badi dhe 2- tutu.

Per realizimin e badit do te perdorim material likra

Per realizimin e tutu-s do te perdorim tyl te ashper I vecante per packa klasike profesionale me veti mosrrudhosje, I cili qepet ne menyre artizanale ku merr formen ideale me vendosjen e pjeses metalike profesionale. Sasia e domosdoshme e tylit per packen 16 m.

Materialet teknike te kostumit:

-fije pambuku

-llastik pambuku

-brileta

Sasia e pritshme 7

#### **8. TUTU (10,12,14)**



Packa perbehet nga dy elemente 1-badi dhe 2- tutu.

Per realizimin e badit do te perdorim material likra

Per realizimin e tutu-s do te perdorim tyl te ashper I vecante per packa klasike profesionale me veti mosrrudhosje, I cili qepet ne menyre artizanale ku merr formen ideale me vendosjen e pjeses metalike profesionale. Sasia e domosdoshme e tylit per packen 16 m.

Materialet teknike te kostumit:

-fije pambuku

-llastik pambuku

-brileta

Sasia e pritshme 7

#### **9. PACKA NEO KLASIKE**



Packa perbehet nga dy elemente 1-badi dhe 2- tutu.  
Per realizimin badi perdorim material likra elastike.  
Per fundin perdorim tyl me xixa dhe bordur me qendisje me lule.  
Stolisia do realizohet me shirita te qendisur me fije akriliku. aplika dhe gure me reflekse.  
Per realizimin e tutu-s do te perdorim tyl te ashper I vecante per packa klasike profesionale me veti mosrrudhosje. Sasia e domosdoshme e tyllit per packen 16 m.

Kjo packe vjen e shoqeruar gjithashtu dhe me aksesoret qe po ashtu jane punime artizanale perkatesisht kurora me rruaza kristali

Materialet teknike te kostumit:

- fije pambuku
- llastik pambuku
- brileta
- Sasia e pritshme 4

## 10. SOLIST MESHKUJ

### a. ROLI “PRINCI TEK BUKUROSHJA E FJETUR”



Kostumi perbehet nga 3 element 1-jeleku 2-kemisha 3- strecet.  
Per realizimin e jelekut perdorim pelhur statike profesionale e dubluar me fortes.  
Per kemishen perdorim pelhur mendafshi e lehte.  
Per strecet perdorim material likra elastike profesionale per kostumet e baletit.  
Stolisia realizohet me aplika ngjyre floriri, kristale me reflekse dhe komca .

Materialet teknike te kostumit

- fije pambuku
  - llastik pambuku
  - vata
  - astar
- Sasia 1

#### **b. ROLI “ZOGU I ZI”**



Kostumi perbehet nga nje trupore dhe krahet.

Per realizimin e trupores perdorim material liker elastike profesionale per kostumet e baletit.

Per realizimin e kraheve perdorim pelhur te lehte.

Stolisia realizohet me aplika ngjyre floriri, kristale me reflekse dhe pend original.

Aksesor plotesues kapele karakter e bere me aplika dhe pend .

Materialet teknike te kostumit

- fije pambuku
  - llastik pambuku
  - vata
  - astar
- Sasia 1

#### **11. KEMISHA PER MESHKUJ (10/12/14)**



Kemishat perbehet nga dy element 1-velut dhe 2- muselin.

Materialet teknike te kostumit:

- fije pambuku
- llastik pambuku

-brileta  
Sasia 8

#### **14.TUTU MESIMI**



Per realizimin e tutu-s do te perdorim tyl te ashper I vecante per packa klasike profesionale me veti mosrrudhosje, I cili qepet ne menyre artizanale ku merr formen ideale me vendosjen e pjeses metalike profesionale. Sasia e domosdoshme e tyllit per packen 16 m.

Materialet teknike te kostumit:

-fije pambuku  
-llastik pambuku  
-brileta  
Sasia e pritshme 5

Shtojca 10

**Sasia e mallrave dhe kushtet e lëvrimit Sasia e mallit që kërkohet:**

<b>"BLERJE VESHJE SPORTIVE PËR SHKOLLËN KOMBËTARE TË FUTBOLLIT "LORO BORIÇI"</b>			
<b><u>Nr</u></b>	<b><u>Emertimi</u></b>	<b><u>Njësia matëse</u></b>	<b><u>Sasia e pritshme</u></b>
1	Komplet përfaqësimi (Xhaketë sporti+ tuta të gjata)	komplete	140
2	Uniforma përfaqësimi për ndeshjet ( Bluzë me mëngë të shkurtra dhe mbathje futbollit të shkurtra	komplete	140

<b>"BLERJE VESHJE POPULLORE PËR SHKOLLËN KOMBËTARE KOREOGRAFIKE"</b>			
<b><u>Nr</u></b>	<b><u>Emertimi</u></b>	<b><u>Njësia matëse</u></b>	<b><u>Sasia e pritshme</u></b>
1	Veshje burrash Tiranë	komplete	8
2	Veshje vajzash Tiranë	komplete	8
3	Veshje tradicionale Librazhdi (vajzash)	komplete	8
4	Veshje burrash jugu.	komplete	8

<b>"BLERJE VESHJE BALETI PËR SHKOLLËN KOMBËTARE KOREOGRAFIKE"</b>			
<b><u>Nr</u></b>	<b><u>Emertimi</u></b>	<b><u>Njësia matëse</u></b>	<b><u>Sasia e pritshme</u></b>
1	Packa profesionale (s/m/l) Roli "Raimonda".	komplete	1
2	Packa profesionale (s/m/l) Roli "Bukuroshja e fjetur".	komplete	1
3	Packa profesionale (s/m/l) Roli "Mjelma e Bardhe".	komplete	1
4	Packa profesionale (s/m/l) Roli "Mjelma e Zeze".	komplete	1
5	Pullupacka profesionale (s/m/l)	komplete	7

Dokumentat Standarde të Tenderit

6	Pullupacka gjysem profesionale (s/m/l)	komplete	7
7	Kemisha per meshkuj (s/m/l)	copë	7
8	Strece per meshkuj (s/m/l)	copë	7
9	Pullupacka te vogla (10, 12, 14).	komplete	7
10	Tutu (s/m/l)	komplete	7
11	Tutu (10, 12, 14)	komplete	7
12	Packa neo klasike	komplete	4
13	Solist meshkuj Roli "Princi tek Bukuroshja e fjetur".	komplete	1
14	Solist meshkuj Roli "Zogu I Zi".	komplete	1
15	Kemisha per meshkuj (10, 12, 14)	copë	8
16	Tutu mesimi	komplete	5

**Afatet e lëvrimet: Nga lidhja e kontratës/kontratave brënda 20 ditëve .**

**Shtojca 11**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër* ]

**PLANIFIKIMI I  
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

Mall: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër		
<b>Kontrata Nr.</b>	<b>Titulli i Kontratës</b>	<b>Përshkrim i shkurtër i kontratës</b>
<b>01</b>		
<b>02</b>		
<b>03</b>		
<b>...</b>		



**Shtojca 12**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor* ]

**NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR<sup>1</sup>**

[vendi dhe data]

[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006, Për Prokurimet Publike.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

---

---

---

---

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

< Emri >

### Shtojca 13

[ Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]

#### FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_  
*numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_  
*numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_  
*numri i NIPT-it*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_  
*numri i NIPT-it*

## Dokumentat Standarde të Tenderit

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

---

---

---

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues*] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [*shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*]/pikët totale të marra [\_\_\_\_\_]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

[Titullari i autoritetit kontraktor]

**Shtojca 14**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM  
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

\* \* \*

Procedura e prokurimit: \_\_\_\_\_

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_  
*numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_  
*numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

## Dokumentat Standarde të Tenderit

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_  
*numri i NIPT-it*
2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_  
*numri i NIPT-it*

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

---

---

---

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_  
*numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_ / Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_  
*numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_ / Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

Etj. \_\_\_\_\_

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_  
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

**[Titullari i autoritetit kontraktor]**

**KUSHTET E PËRGJITHSHME**  
**Mallrat –Kërkesë për propozim**

**Neni 1: Qëllimi**

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për blerjen e Mallrave të prokuruar me anë të procedurës me negociim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

**Neni 2: Përkufizime**

- 2.1 “kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga Dokumentat e Tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha shtojcat dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontraktore.
- 2.3 “Incoterms” do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë detyrimet përkatëse, kostot, dhe risqet e lidhura me transferimin e Mallrave nga shitësi tek blerësi.
- 2.4 “Lëvrimi” do të thotë të gjitha aktivitetet dhe veprimet që mundësojnë marrjen e Mallrave në vendin e shpërndarjes siç specifikohet në kontratë si paketimi, transportimi, sigurimi, tarifrat, procedura doganore, ngarkimi dhe shkarkimi, instalimi, mbledhja, bashkimi, kontrollimi i veprimeve dhe mbikëqyrja e gjithë kësaj veprimtarie.
- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen Mallrat. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.

## Dokumentat Standarde të Tenderit

- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon Mallrat.
- 2.7 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.8 “Mallrat” do të thotë materialet e papërpunuara, produktet, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë, të lëngshme ose të gaztë.
- 2.9 “Shërbimet e lidhura me to” do të thotë shërbimet ndihmëse ose të paparashikuara të furnizimit të Mallrave, si transportimi, instalimi, mirëmbajtja, trajnimi, shërbimet mbështetëse ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimin e Mallrave.
- 2.10 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Mallrat dhe Shërbimet e lidhura me to që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.11 “Standarde Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një organ i posaçëm standardizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose përkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

### **Neni 3: Hartimi i Kontratës**

- 3.1 Njoftimi i ofertës fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të parashikuar në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

### **Neni 4: Praktikat e Korruptuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve**

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ndonjë ent tjetër që ka marrë pjesë në përgatitjen e Dokumentave të Tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

### **Neni 5: Informacioni Konfidencial**

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.

- 5.2 Kontraktuesi mund t'i japë nënkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar për nënkontraktuesin të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nën-Kontraktuesin një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencialitetit siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

#### **Neni 6: Pronësia Intelektuale**

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetin Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Kontraktuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i parashtrijë Autoriteti Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramet, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdorë për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktuesi duhet të shkarkojë Autoritetin Kontraktor nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronësisë intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose shpërndarja e Mallrave sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronësisë intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i Mallrave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

#### **Neni 7: Origjina e Mallrave**

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së mallrave, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktuesi mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e mallrave.
- 7.3 Për qëllime verifikimi, "origjinë" do të thotë vendi ku mallrat janë nxjerrë, ose prodhuar. Mallrat janë prodhuar kur, nëpërmjet përpunimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e mallrave ka dallim nga kombësia e Kontraktuesit ose nënkontraktuesit që siguron mallrat.

#### **Neni 8: Qëllimi i Furnizimit dhe Përshtatshmëria e Mallrave me Specifikimet**

- 8.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat në përputhje me cilësinë, sasinë dhe llojin e



specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.

- 8.2 Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën, nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin e posaçëm të parashikuar në kontratë. Kur nuk është e mundur të përcaktohet një gjë e tillë, thuhet se Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin për të cilin shërbejnë zakonisht sendet e tjera të të njëjtit lloj.
- 8.3 Nëse shitja është bërë në bazë të një modeli ose kampioni, shitësi (Kontraktuesi) duhet të dorëzojë sendet që kanë të njëjtat cilësi si të modelit ose kampionit.

#### **Neni 9: Përputhshmëria e Mallrave me Standardet Teknike**

- 9.1 Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konform kodeve dhe Standardeve Teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në kodet përkatëse ose në Standardet Teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti Kontraktor.
- 9.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë dispozite tjetër e kontratës, kur nuk është përcaktuar asnjë Standard Teknik përkatës në specifikimet teknike, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike ndërkombëtare. Nëse nuk ekzistojnë Standarde Teknike ndërkombëtare, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike përkatëse Shqiptare.
- 9.3 Kontraktuesi nuk mban përgjegjësi për gabime në skicim, të dhëna, vizatim ose çdo aspekt tjetër të specifikimeve teknike të dhëna nga Autoriteti Kontraktor me përjashtim të rastit kur gabimi ishte aq i dukshëm sa Kontraktuesi duhet ta kishte parë dhe këshilluar Autoritetin Kontraktor për të.
- 9.4 Shitësi (Kontraktuesi) nuk mban përgjegjësi për defekte të Mallrave për të cilat Autoriteti Kontraktor ishte në dijeni në momentin e lidhjes së kontratës ose nuk ishte në dijeni për faj të tij, me përjashtim të rastit kur defektet kanë të bëjnë me cilësinë e Mallrave të specifikuar sipas kontratës ose përfaqësimin e reklamës se shitesit (Kontraktuesit).

#### **Neni 10: Pjesët e Këmbimit**

